



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

**A.nr. 395/2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 12.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**MIRATOHET** ankesa si e bazuar e subjektit politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK).

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 4000 (katërmijë) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A r s y e t i m**

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 09.12.2010, nga subjekti politik PDK në të cilën pretendohet se më datë 08.12.2010 në lagjen Dardani në Prishtinë, subjekti politik LDK, ka mbuluar posterat e subjektit politik PDK, me posterat e tyre, e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur 2 (dy) fotografi si dëshmi, në të cilat shihet qartë se posterat e subjektit politik LDK, janë vendosur mbi posterat subjektit politik PDK. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

### **Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:**

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 10.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet në ankesë deri më datë 11.12.2010, gjerë në ora 12:00. PZAP-i, mori përgjigje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar, në të cilën theksohet në ankesë nuk sqarohet qartë se nga kush është bërë vendosja e posterave mbi postera të subjektit tjetër politik, andaj në përgjigje të ankesës potencohet se për shkak të kohës së shkurtër për tu përgjigjur në ankesë nuk kemi mundur të sigurojmë prova për largimin e posterave, dhe njëkohësisht shpreh keqardhje për atë që ka ndodhur.

## Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërsi si në vijim:*

*a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posterit ose materialit tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;*

### Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

*Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:*

*c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).*

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

**- ankesa është e bazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se subjekti politik LDK shkeljet e kësaj natyre i ka përsëritur në vazhdimësi andaj konsiderohet recidivist rrethanë e cila ndikon në lartësinë e dënimit të shqiptuar në gjobë. Prandaj nga arsyet e lartcekura, ne kuptim te nenit 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 395/2010 më datën 12.12.2010

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

